



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3027/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

## V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2026:
  - Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri, BA Profesional, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
  - Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- II. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
  - Inxhinieri Industriale me Informatikë, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
  - Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit, BSc, 180 ECTS, maksimumi 150 studentë për vit akademik.
- III. Akreditohet programi i studimit i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
  - Informatika e Aplikuar, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
- IV. Nuk akreditohet programi i studimit i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj:
  - Menaxhment Industrial, MSc, 120 ECTS.
- V. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.

VI. Obligohet Universiteti të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj që deri më datë 15.11.2021, të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.

VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

I. Unëversiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim dhe riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri, Bachelor Professional, 180 ECTS Ri-akreditim	Ismet Musliu Lulzim Idrizi Agim Thaçi Kushtrim Cukaj
2	Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Ramadan Topuzi Leonora Haliti Rudhani Rrahim Sejdiu Muhamet Ymeri
3	Inxhinieri Industriale me Informatikë, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Milihate Aliu Bashkim Çerkini Valdete Braha Arben Tërstena
4	Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit, me specializim në 1. Menaxhment i Hotelierisë dhe 2. Menaxhment i Turizmit BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Mimoza Zhubi Arbresha Meha Bashkim Musliu Idriz Kovaci Petrit Hasanaj
5	Informatika e Aplikuar, BSc, 180 ECTS Akreditim	Dhuratë Hyseni Fakije Zejnullahu Bashkim Mustafa
6	Menaxhment Industrial, MSc, 120 ECTS Akreditim	Afrim Loku Ismajl Mehmeti Fahri Bushi

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar dy vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 09.02.2021 dhe 23.02.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Nana Dikhaminjia, Marija Vasilevska, Peeter Normak, Dražen Vrhovski, Asnate Kažoka, Lina Nunes, Alexander Petutchnigg, Mikus Dubickis dhe Yelena Istileulova.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:



1. Programi i studimit Dizajni dhe Konstruksionet e Produkteve nga Druri, BA Professional, 180 ECTS: Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, ky program i përmbush: plotësisht dy (2) dhe substancialisht pesë (5) kapituj.
2. Programi i studimit Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobileve ( me specializim në: 1. Arkitekturë e Interierit dhe 2. Dizajn i Mobileve), BSc, 180 ECTS: Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se: nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, ky program i përmbush: plotësisht tre (3) kapituj, ndërsa i përmbush substancialisht katër (4) kapituj.
3. Programi i studimit Inxhinieri Industriale dhe Informatikë, BSc, 180 ECTS: Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se: nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, ky program i përmbush: substancialisht pesë (5) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj.
4. Programi i studimit Menaxhment i Hotelierisë dhe Turizmit (me specializim në 1. Menaxhment i Hotelierisë dhe 2. Menaxhment i Turizmit), BSc, 180 ECTS: Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se: nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, ky program i përmbush: substancialisht pesë (5) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj.
5. Programi i studimit Informatika e Aplikuar, BSc, 180 ECTS: Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se: nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, ky program i përmbush: plotësisht dy (2) kapituj, ndërsa i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj.
6. Programi i studimit Menaxhment Industrial, MSc, 120 ECTS: Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se: nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit, ky program i përmbush: substancialisht dy (2) kapituj, ndërsa i përmbush pjesërisht pesë (5) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë